

## STATUTI DHE AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “LEGAL CONSTRUCTION” SH.P.K.

Sot, më 28/04/2021 ne ortakët: 1. Shoqëria FRIGO ALBA shpk me NIPT K51725005T përfaqësuar nga administratori i saj Z. Luan Jazexhiu i biri i Sulejman lindur dhe banues në Tiranë më 14.11.1965 shtetas Shqiptar mbajtës I letërnjoftimit me nr. 036115857; 2. Shoqëria HAKO shpk me NIPT J72122003T përfaqësuar nga administratorja Znj. Antonela Hako e bija e Thoma lindur dhe banuese në Tiranë më datë 06.08.1966 shtetase Shqiptare mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 035531551; Shoqëria INTERNATIONAL FOODS me NIPT K22826403L përfaqësuar nga administrator z. Arqile Pojani i biri i Koçi i lindur në Fier dhe banues në Tiranë më 17.11.1961 mbajtës I letërnjoftimit nr. 034066053

Të cilët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë në cilësinë e ortakëve të shoqërisë bazuar ne legjislacionin shqiptare hartojnë këtë statut të shoqërisë tregtare LEGAL CONSTRUCTION SH.P.K. e cila ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (shpk), e cila do te funksionoj në përputhje me ligjin Shqiptar dhe në përputhje me këtë statut.

#### BAZA LIGJORE

- “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;
- “Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- “Ligji Nr. 9723 dt. 03/05/2007 “Për Qëndren Kombëtare të Rregjistrimit ”;
- “Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë ”;

#### STATUTI

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1: Emertimi i Shoqërisë

Kam vendosur krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me emrin “LEGAL CONSTRUCTION” SH.P.K. me poshte e quajtur edhe Shoqëria. Emri i shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të asamblesë.

##### Neni 2 Forma e Shoqërisë

Shoqëria tregtare “LEGAL CONSTRUCTION” shpk është një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar

##### Neni 3: Selia e Shoqërisë



3.1 Selia e shoqërisë “LEGAL CONSTRUCTION” SH.P.K. është Njësia Administrative Nr. 11 Rruga Egnatia Ndërtesa nr. 72 Tiranë;

3.2 Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

**Neni 4: Objekti i aktiviteti:**

1. Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktivitetit tregtar në përputhje me legjislacionin Shqiptar;
2. Ndërtime civile dhe industriale si ndërtimin e rrugëve, ujësjellësve, kanale kullimi, punë hidraulike dhe punë publike, private të cdo lloji, restaurime, mirëmbajtje dhe riparime ndërtesash në përgjithësi;
3. Ndërtim për llogari të saj ose të një pale të tretë fabrikatesh, ndërtesash civile, ndërtesa tregtare ose sidoqoftë përmbushjen e të gjitha aktiviteteve lidhur me ndërtimin;
4. Shoqëria mund të kryejë të gjitha punët e ndërtesave banuese, industriale, tregtare, financiare që do të konsiderohen të rëndësishme për përmbushjen e nevojave sociale;
5. Import -eksport të artikujve të ndryshëm industrial, makineri, pjesë ndërtimi, materiale ndërtimi, pajisje dhe makineri elektrike dhe elektronike;
6. Shoqëria mund të kryejë aktivitet tregtarë në fushën e real estate për ndërtesat që do të ndërtojnë vetë ose për llogari të personave të tretë.

**Neni 5: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë “LEGAL CONSTRUCTION” SH.P.K.do të jetë për një periudhë të pacaktuar duke filluar nga moment i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tirane

**Neni 6**

*Filiale dhe zyrat e përfaqësisë*

Shoqëria Tregtare “LEGAL CONSTRUCTION” SH.P.K. mund të ketë filial ose zyra përfaqësie në territorin Shqiptar ose të huaj.

**KREU III**

**NENI 7 Kapitali themeltar i shoqërisë**

7.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 (nje qind) lekë.

7.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 3 kuota të gjitha të nënshkruara dhe firmosura



## NENI 8 Kontributet

Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

8.1. Shoqëria FRIGO ALBA shpk me NIPT K51725005T zotëron një kuotë e cila korrespondon me 50% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 50 (pesëdhjetë) lekë;

8.2. Shoqëria HAKO shpk me NIPT J72122003T zotëron një kuotë e cila korrespondon me 25% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 25 (njëzet e pesë) lekë;

8.3 Shoqëria INTERNATIONAL FOODS me NIPT K22826403L zotëron një kuotë e cila korrespondon me 25% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 25 (njëzet e pesë) lekë.

8.4 Kapitali themeltar i përbërë nga 3 kuota është shlyer dhe nënshkruar i gjithë sipas përqindjeve të secilit ortak.

## NENI 9 Zmadhimi i kapitalit

9.1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet pa limit një ose më shumë herë me anë të vendimit të asamblesë së ortakëve;

9.2. Në rast të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë, ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe paguajnë pjesën e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesën takuese të pjesëmarrjes në kapitalin social të shoqërisë.

## NENI 10

### Zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë

10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e saj me vendim të asamblesë së ortakëve. Në cdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të ulet nën limitin dysHEME të vendosur me ligj;

10.2 Zvogëlimi i kapitalit social i prek ortakët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë, përveç rastit kur asamblea e përgjithshme mund të vendosë ndryshe.

## NENI 11

### Transferimi i kapitalit

11.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të kalohen të tjerëve plotësisht ose pjesërisht;

11.2 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të kalohen të tjerëve plotësisht ose pjesërisht personave të tretë jashtë kësaj shoqërie, por duke respektuar këto klauzola:



- Ortakët kanë të drejtën e parablerjes për kuotat që dëshiron të transferojë/kaloj
- Ortakët kanë të drejtën e parablerjes së kuotave me të njëjtat kushte dhe të njëjtin çmim me të cilin ortaku mund të ja shiste një personi të tretë kuotën e tij. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i komunikimit për shitjen ortakët duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes, në rast të kundërt do të konsiderohet se kanë hequr dorë nga kuota;
- Në rast se ortaku që dëshiron të shesë kuotën e tij, ja kalon një personi të jashtën nga shoqëria me kushte më të favorshme në krahasim me ato të ofruara ortakëve në lidhje me të drejtën e parablerjes nga ana e tyre, atëherë kontrata për kalimin e kuotave që do të nënshkruar me personin e tretë nuk do të jetë i vlefshëm dhe shoqëria dhe ortakët nuk do të japin miratimin për këtë kalim.

11.3 Të gjitha komunikimet midis ortakëve do të bëhem me shkrim dhe me postë rekomande me lajmërimim marrje.

#### KREU IV

#### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

##### NENI 12 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

##### NENI 13

#### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ASAMBLESË

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;



- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) largimin dhe përjashtimin e ortakëve;
- j) Marrjen kredi apo hipotekimin e aseteve të shoqërisë.
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

#### NENI 14

#### MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

14.1 Asambleja e përgjithshme thirret në rastet e parashikuara nga ligji ose në statut, sa herë do të konsiderohet e nevojshëm për mbrojtjen e interesave të shoqërisë

14.2 Asambleja duhet të thërritet të paktën një herë në vit;

14.3. Asambleja e përgjithshme thirret sipas parashikimeve të nenit 83 dhe 84 të ligjit nr. 9901, datë 14.01.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

14.4. Ortakët do të njoftohen nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

14.5. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas këtyre rregullave dhe sipas këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë;

14.6. Mbledhja e përgjithshme e asamblesë mund të mbahet në selinë qendrore të shoqërisë ose në një vend tjetër të përcaktuar.

#### NENI 15 Pjesëmarrja në vendime

15.1 Ortakët kanë të drejtën e votës në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin social;

15.2. Ortakët mund të përfaqësohen në asamble nga një person i tretë në bazë të një autorizimi. Ky autorizim mund të lëshohet për një mbledhje të vetme ose mbi më shumë mbledhje.

#### NENI 16



## PROCESVERBALI I MBLEDHJES

Të gjitha vendimet e mbledhjes do të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali duhet të përcaktojë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e presidentit të mbledhjes, emrin e sekretarit të mbledhjes dhe rezultatin e votimit;

Presidenti i mbledhjes përcakton kush do të jetë sekretari për redaktimin e procesverbalit i cili mund të mos jetë ortak. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga presidenti dhe nga sekretari.

Procesverbalit i bashkëlidhet emrat e personave prezent dhe njoftimi për thërritjen e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

### NENI 17

#### Administratori

Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratori ka të drejtën e administrimit të zakonshëm të shoqërisë.

Ka të drejtë kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

Ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë tregtare përpara cdo institucioni publik ose privat;

Ka të drejtë të përgatisë cdo lloj akti të nevojshëm për ecurinë e shoqërisë dhe ta depozitojë pranë cdo institucioni publik ose privat sipas ligjeve në fuqi;

Merret me menaxhimin e përditshëm të shoqërisë duke kryer të gjitha aktivitete e nevojshme për menaxhimin dhe dhe mbikqyrjen e personellit; kryen punësimet dhe pushimet nga puna; përcakton udhëzime për kryerjen e detyrave për aktivitetin e shoqërisë; mban korrespondencën e shoqërisë; autorizon mblerjen, qiran e sendeve ose shërbimeve të nevojshme të lidhura direkt ose indirect me aktivitetin tregtar të shoqërisë; autorizon kryerjen e trasfertave bankare ose tërheqjen e shumave nga llogaritë rrjedhëse të shoqërisë në lidhje me pagesat e pagave ose shpërblimet e punonjësve të shoqërisë; firmos faturat për shërbimet dhe veprimet që shoqëria kryen; kryen të gjitha veprimet e nevojshme përsa i përket nënshkrimit të cdo pagese bankare, depozitat, tërheqjet, derdhjet ose trasfertat të ndryshme në llogaritë e shoqërisë të të gjitha llogaritë e shoqërisë, pranë cdo banke në të cilën llogaritë janë hapur;

Përfaqëson shoqërinë në lidhje me cdo kontratë ose marrëveshje me të tretët persona fizike ose juridike, vendas ose të huaj, me intucione ose ente publike të çfarë do lloji;



Për administrimin e jashtëzakonshëm të shoqërisë që kalon tagrat e mësipërm administratori duhet paraprakisht të ketë marrë miratimin e asamblesë së përgjithshme.

Administratore e shoqërisë LEGAL CONSTRUCTION do të jetë Znj. Enkelejda Jazexhiu e bija e Zihni me datëlindje 22.08.1971 e cila do të administrojë aktivitetin e zakonshëm të shoqërisë, ndërsa përsa i përket administrimit të jashtëzakonshëm, hapjen e llogarive bankare, depozitat, marrja krediti ose hipotekim te pasurive të shoqërisë do të jetë e nevojshme gjithmonë vendim i asamblesë së ortakëve.

## KREU V

Ekspertet kontabil, viti Financiar dhe Bilanci, Destinimi i të ardhurave

### Neni 18 Viti Financiar dhe të ardhurat

18.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor të po atij viti.

18.2 Bilanci vjetor, inventari, raporti mbi ecurinë e aktivitetit tregtar dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar aprovohen nga asambleja e përgjithshme.

18.3 Bilanci dhe pasqyrat financiare për vitin financiar duhet të aprovohen brenda 3 muajve nga përfundimi i vitit financiar

### NENI 19 Shpërndarja e të ardhurave

Të ardhurat i shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesëmarrjen dhe kuotat e tyre

Shoqëria mund të shpërndajë të ardhurat vetëm nëse:

- Aktivitetet e shoqërisë mbulojnë plotësisht detyrimet e tyre;
- Shoqëria posedon aktive në likuiditet të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm.

## KREU VI

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

### NENI 20 Mbyllja dhe likuidimi

20.1 Shoqëria shpërndahet ose priset në cdo kohë në rastet e parashikuar nga ligji ose asambleja e përgjithshme :

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;



b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

## KREU VII

### DISPOZITA TË FUNDIT

#### NENI 21 Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen me marrëveshje në rast se nuk arrihet marrëveshja atëherë kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### NENI 22

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë

Ky statut dhe akt themelimi janë mbajtur në 4 kopje në gjuhë shqiptare.

SHOQËRIA

SHOQËRIA

SHOQËRIA

HAKO SHPK

FRIGO ALBA SHPK

INTERNATIONAL FOODS SHPK

